



REPUBLIKA ESHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
SENATI AKADEMIK

Nr 1479 Prot.

Gjirokastër, më . 08 / 11 /2019

V E N D I M

Nr. 21 , datë 08. 11. 2019

**MIRATIMI I HAPJES SË PROGRAMEVE TË CIKLIT TË PARË "BACHELOR" PAS
PËRFUNDIMIT TË REGJISTRIMEVE PËR VITIN AKADEMIK 2019 - 2020
DHE
MIRATIMI I SHPALLJES JO AKTIVE I TRE PROGRAMEVE TË STUDIMIT PËR
VITIN AKADEMIK 2019-2020**

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015 " Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë ", udhëzimit nr 10, datë 15 .05. 2019 " Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve në institucionet e arsimit të lartë ", udhëzimit nr. 17, datë 30.07.2019 " Disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 10, datë 15. 05. 2019 , "Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, në institucionet e arsimit të lartë ", Vendimit nr. 418, datë 10.05.2017 "Për Standartet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre ", dhe Vendimit nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë " , Senati Akademik i Universitetit "Eqrem Çabej në mbledhje e tij të datës, 08. 11. 2019, diskutoi rreth regjistrimeve të reja në programet e studimit të

ciklit të parë që Universiteti “Eqrem Çabej” ofron për vitin akademik 2019 - 2020 , pas përmbylljes të të gjitha fazave të regjistrimeve në zbatim të udhëzimit të sipërcituar dhe

VENDOSI:

1. Të miratojë hapjen e atyre programeve të studimit të cilat kanë një numër të ulët të studentëve të regjistruar për vitin akademik 2019 – 2020 të cilëve u shtohet edhe numri i studentëve sipas kategorive si mëposhtë:
 - Të transferuar
 - Me program të dytë studimi
 - Përsëritës në vitin e parë
2. Në zbatim të udhëzimit nr. 31, Kreu IV, pika 1/c , datë 29.12.2017 “Për përcaktimin për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e programeve të studimit nga institucionet e arsimit të lartë, miraton shpalljen jo aktive për vitin akademik 2019-2020 për mos regjistrimin e studentëve në programet e studimit të mëposhtme:
 - Program i studimit të ciklit të parë “Bachelor” në Matematikë – Fizikë
 - Program i studimit të ciklit të parë “Bachelor ” në Fizikë dhe Teknologji Informati
 - Program i studimit të ciklit të parë “Bachelor” në Gjuhë Italiane
3. Bashkangjitur këtij vendimi gjendet dhe tabela përmbledhëse për vitet e para në të gjitha programet e studimit për të dyja ciklet e studimit që ofron UGj-ja .
4. Ky vendim i përcillet Bordit të Administrimit të Universitetit “Eqrem Çabej”.


REKTOR
Prof. dr Bektash MEMA

